



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20. prill 2012
Nr.Ref.:RK219/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 32/11

Parashtruesi

Lulzim Ramaj

Kërkesë për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së

GJKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almira Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Lulzim Ramaj nga Peja.

Ankesat dhe pretendimet e parashtruesit

2. Ankesa e parashtruesit buron nga mohimi i statusit të veteranit nga organizata e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).
3. Parashtruesi pohon që me këtë veprim, organizata e UÇK-së i ka shkelur nenet 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe 24 [Barazia para Ligjit], të parashikuara me Kapitullin II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore] të Kushtetutës.
4. Parashtruesi më tej pohon për shkelje të nenit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nenit 29 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe nenit 2 të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike.
5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

6. Parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata), bashkë me dokumentacionin e nevojshëm, më 3 mars 2011.
7. Të njëjtën datë, parashtruesi dorëzoi “një kërkesë për mospublikim” në “mediet publike, në mediet e shkruara dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës”.
8. Më 18 prill 2011, Kryetari e caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Snezhana Botusharova dhe Ivan Čukalović.
9. Më 18 janar 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës për papranueshmëri të kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

10. Më 17 shtator 2010, parashtruesi dorëzoi një kërkesë në Organizatën e Veteranëve të UÇK-së, dega në Pejë, për njohjen e statusit të veteranit të UÇK-së dhe gjithashtu kërkoi lëshimin e “librezës së UÇK-së”.
11. Më 12 tetor 2010, për shkak të heshtjes administrative nga dega në Pejë, duke u bazuar në nenin 131 të Ligjit për procedurën administrative në Kosovë (Ligji Nr. 02/L-28), parashtruesi paraqiti ankesë në Organizatën Qendrore të Veteranëve të UÇK-së në Prishtinë.
12. Më 13 dhjetor 2010, parashtruesi paraqiti peticion në Gjykatën Supreme të Kosovës në Prishtinë për shkak të faktit se nuk kishte marrë asnjë vendim për ankesën e tij drejtuar Organizatës Qendrore të Veteranëve të UÇK-së.
13. Më 28 dhjetor 2010 dhe më 29 janar 2011, parashtruesi paraqiti ankesa në Këshillin Gjyqësor të Kosovës kundër mosveprimit nga Gjykata Supreme.

14. Më 9 shkurt 2011, parashtruesi mori një letër nga Zyra e Prokurorit Disiplinor e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me anë të së cilës njoftohej se parashtrësia e tij lidhur me vonesën e Gjykatës Supreme të Kosovës për shqyrtim nuk e përmbushte kriterin kohor për t'u shqyrtuar.
15. Më 9 shkurt 2011, parashtruesi përsëri iu drejtua me një kërkesë Këshillit Gjyqësor të Kosovës me ç'rast kërkoi të shqyrtoheshin ankesat e tij të 28 dhjetorit 2010 dhe të 29 janarit 2011.
16. Parashtruesi pohon që nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës lidhur me kërkesën e tij të 9 shkurtit 2011.
17. "Kërkesa për mospublikim", e përmendur më sipër, nuk mbështetet me asnjë bazë apo justifikim faktik.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

18. Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuar më tej në Ligjin për Gjykatën Kushtetuese dhe në Rregullore të punës.
19. Gjykata rikujton që substanca e kërkesës së parashtruesit është mohimi i njohjes së statusit të veteranit të UÇK-së.
20. Gjykata vëren që në periudhën prej 17 shtatorit 2010 e deri më 9 shkurt 2011, parashtruesi kishte dorëzuar një sërë kërkesash në organet dhe institucionet e ndryshme shtetërore në të cilat e përsëriste kërkesën e tij. Parashtruesi gjithashtu e dorëzoi një petition në Gjykatën Supreme më 13 dhjetor 2010 për shkak të heshtjes nga Organizata Qendrore e Veteranëve të UÇK-së.
21. Parashtruesi pohon që nuk ka marrë asnjë vendim nga Gjykata Supreme.
22. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton që në përputhje me nenin 113 (7) të Kushtetutës *"Individët janë të autorizuar të ngrënë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."*
23. Peticioni i parashtruesit ende është në procedurë në Gjykatën Supreme. Prandaj, duket që kërkesa e tij është e parakohshme. Ky konkluzion është në përputhje me informacionin që parashtruesit i është dhënë nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës se *"parashtrësia e tij lidhur me vonesën e Gjykatës Supreme të Kosovës për shqyrtim nuk e përmbush kriterin kohor për t'u konsideruar se është duke u vonuar nga Gjykata"*.
24. Sa i përket "kërkesës së parashtruesit për mospublikim", ajo duhet të konsiderohet si kërkesë për konfidencialitet. Megjithatë, Gjykata vëren që kërkesa është dorëzuar pa asnjë arsytim. Si rrjedhojë, refuzohet si qartazi e pabazuar.

PËR KËTO ARSYE

Në pajtim me nenin 113 (7) të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit, Gjykata Kushtetuese njëzëri:

VENDOSI


- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20 (4) të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani